

Ndërtimtaria kryesore

Patronët me pseudo-sindikate

2

Pasoja e fuqizimit të frangut

Jo në kurriz të punëtorëve

3

Bota e punës në Kosovë

Sa vijnë e shtohen protestat e punëtorëve

4

Nr. 2 | prill 2015 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Dite e punës

Drejtësi sociale në vend të përjashtimit!



Pamje nga demonstrata e grave në Bernë më 7 mars 2015 për barazi në paga

Për kushte të mira pune dhe shpërndarje të drejtë të pasurisë iu është dashur të luftojnë qe shumë kohë punëtorëve. Edhe 125 vjet pas manifestimit të parë të 1 majit ne vazhdojmë të luftojmë për drejtësinë sociale dhe kundër përjashtimit të më të rrezikuarve në shoqëri!

Më 1890 në Zvicër dhe në vendet tjera të Evropës për herë të parë sindikalistet e sindikalistet dolën bashkërisht në rrugë. Ata iu përgjigjën thirrjes së Lidhjes Ndërkombëtare të Punëtorëve. Kjo e fundit, pat shpallur 1 majin ditë ndërkombëtare të punës, pas përlëshjeve të rrepta në Çikago me rastin e një greve për 8 orë pune në ditë. Me zë të lartë edhe koleget e kolegët kërkuan 8 orët e punës. Patronët nuk donin t'ia dinin. Ne kemi dalë kundër tyre.

Një luftë e gjatë dhe e rreptë

Lufta për kushte më të mira pune dhe një pjesëmarrje të drejtë në frytet e punës janë zhvilluar ashpër. Në vendin e punës dhe në rrugë. Demonstratat e 1-majit u bënë me të zëshme dhe më numerike. Që nga ajo kohë ne kemi arritur shumë: Uljen e orëve të punës – në shumë ndërmarrje deri në nivelin e kërkuar më 1890, futja e pushimeve, rritja e pagave, përmirësimi i sigurisë në punë, krijimi i sigurimit aksidental,

shëndetësor dhe atë të pensionit. Shkurt: Lëvizja punëtorë arriti të fitojë më shumë drejtësi sociale.

Më pak shumë të pasur, shumë edhe më të varfër

Më 2015 kjo luftë nuk përfundon. Zvicra është aq e pasur sa asnjëherë më parë. Ne do të mund të lejojmë vetes që të gjithë punëtorët e punëtorët, të gjithë pensionistët e pensionistët ti kenë punët më mirë. Mjerisht realiteti është ndryshe. Dallimet sociale janë duke u rritur. Të ardhurat dhe pasuria janë të shpërndara jashtëzakonisht pabarabartë. Hendeku mes lartë dhe poshtë sa vjen e rritet. Punëmarrësit e moshuar i detyrojnë të kalojnë nga bota e punës në ndihmë sociale. Më vonë këta paguajnë këtë padrejtësi me pensione të varfëruara. Për njerëzit e rinj është bërë edhe më vështirë të hyjnë më shpejt në tregun e punës. Papunësia me 4,9% është e lartë. Presioni në paga po rritet. Ndërsa presioni në vendin e punës është ndritur ndjeshëm. Kundër tërë kësaj do të demonstrojmë ne.

Fitime në kurriz të punëtorëve

Në vend se ti rreken problemeve, partitë e djathta (borgjeze), shoqatat e biznesit dhe punëdhënësit minojnë drejtësinë sociale. Janë të shumë patronët, të cilët Frangun tejet të forcuar e marrin si shkas, për të rritur pakufishëm përfitimet e tyre. Partitë borgjeze dhe shoqatat e biznesit promovojnë receta e tyre të njohura: de-rregullimi (liberalizimi), reduktimi i shërbimeve publike, programe kursimi, shkurtimet të mirëqenies, ulje tatimore për korporatat dhe të pasurit dhe heqja dorë nga masat që duhej ndërmarrë qysh moti si zbatimi i kushtetutës për barazinë në paga. Për këtë do të demonstrojmë ne.

Atakohen më të dobët

Në vend se të zgjidhin problemet, nevojat dhe frika e njerëzve menaxhohen për kampanja përjashtuese: Kundër pranuesve të ndihmave sociale, kundër përfituesve të pensioneve të invaliditetit, kundër pakicave religjioze dhe para së gjithash kundër migrantëve/eve. Përjashtimi dhe diskriminimi, nuk dëmtojnë vetëm të prekurit, por edhe shoqërinë dhe rrezikojnë mirëqenien. Kundër tërë kësaj do të demonstrojmë ne.

Për drejtësi sociale!

Pagat dhe pensionet, kushte të mira pune, vende të sigurta pune në Zvicër janë ekonomikisht të mundshme. Është çështje vullneti dhe raporti forcash. Andaj, të kërkojmë me zë të lartë: Paga të mira dhe pensione më të mira, kushte të mira pune dhe punë të plotë. Ne kërkojmë dhe jemi për një Zvicër të drejtë, solidare, pa diskriminim dhe të hapur. Për këtë angazhohemi ne. Andaj, në vitin e 125-të festimit të 1-majit ne brohorasim zgjedhje tonë për vendin: Drejtësi sociale në vend të përjashtimit!

⇒ SGB / Aurora Garcia



Pllakata e manifestimit të sivjem të 1-Majit

Editorial



Sukses i madh i demonstratës së grave

Mbi 12000 persona dërguan mesazhin e qartë se në Zvicër përfundimisht duhet të paguhet paga të njëjta për punë të njëjtë. Demonstrata në të cilën morën pjesë edhe shumë burra e gra të reja, paraqet demonstratën më të madhe dhe më të suksesshme për barazi deri më tani. Ky sukses mobilizimi ishte i mundur, pasi kjo demonstratë u bartë nga bashkëpunimi i 48 organizatave: nga sindikalistet, grave bujq dhe ekonomistëve, si dhe edhe nga organizatat dhe partitë e djathta, kishata dhe ato të majta. Për zemërim të veçantë gjithashtu ka kontribuar frangu i fuqizuar, i cili ka shkaktuar situatë fortë të tensionuar ekonomike, e edhe më shumë ka shërbyer si një justifikim për të vazhduar kursimin nga pagat e grave.

Me manifestin e barazisë në paga, nja 100 gra të njohura dhe 5.500 nënshkrime të burrave dhe grave vunë një shenjë të qartë se neni kushtetues për pagesë të barabartë të pagave nuk duhet reduktuar në një artikull ekonomik. Me rastin e dorëzimit të këtij manifesti Këshilltarja Federale Simonetta Sommaruga, u zotua se do të angazhohet me këmbëngulësi për zbatimin e pagës të barabartë nëpër kompani dhe se në të ardhmen do të ashpëruar inspektimet për të zbatimin e ligjit të barazisë. Punëdhënësit dhe shumica e partive borgjeze tashmë kanë paralajmëruar rezistencë të ashpër. UNIA dhe një koalicion i gjerë i grave në CVP, BDP dhe FDP do të qëndrojnë në të njëjtin kurs dhe do të rrisin edhe më tej presionin. Kështu ne do të mundemi – ashtu si me rastin e futjes së Ligjit për Barazi më 1995 – së bashku të jemi të suksesshëm!

Corinne Schärer

Anëtare e Drejtorisë Qendrore

News

Të punësuarit në Tesin kundërshtojnë krizës se frangut

Rreth 100 të punësuar e prodhuesit të plastikë Exten SA në Mendrisio më 25 shkurt vendosën të hyjnë në grevë. Ata duan të mbrohen kundër shkurtimeve masive të pagave, që synojnë të zbatojë kompanitë nën pretekstin e frangut të fortë zviceran. Kështu, Drejtoria i njoftoi për shkurtime masive të pagave të 16% për banorët vendës dhe 26% për punonjësit kufitarë, dhe refuzoi të vënë numrat në tryezë në mënyrë që të justifikojë vendimin. Si përgjigje, stafi vendosi për të ndaluar punën. Ata bënë thirrje për tërheqjen e shkurtimeve të pagave, të shohin rezultatet financiare të kompanisë dhe formimin e një komisioni të përhershëm. Punonjësit kanë pezulluar grevën e tyre, pasi kompania ka tërhequr të paktën përkohësisht shkurtimet e pagave. Partnerët socialë tani kanë kohë deri në fund të prillit për të kërkuar zgjidhje.

Konferenca e parë e sektorit për mbështetje dhe përkujdes afatgjatë



Delegatët nga e tërë Zvicra më 16 mars janë takuar në Bernë në konferencën e parë të sektorit për mbështetje dhe përkujdesje afatgjatë. Ta theksuan: Përkujdesja e mirë kërkon kushte të mira pune. Përmes një rezolute u kërkua njëzëri nënshkrimi i Kontratës Kolektive të Punës për tërë sektorin. Për të arritur këtë qëllim, delegatët kërkuan njëzëri nisjen e një kampanje kombëtare për tërë sektorin dhe intensifikimin e aktiviteteve të Unia-s në rrafshin shëndetësor dhe atë të përkujdesjes.

Ngadhënjim i pjesshëm i grevistëve të Gjenevës



Pas dy ditëve grevë punonjësit e firmës Mecalp Technology në Meyrin (Gjenevë) është arritur suksesi i parë: Ndërmarrja ka tërhequr shkurtimet e planifikuara drastike të pagave nga 10% dhe largimin e menjëhershëm nga puna. Nuk u arrit pajtim deri më tani për zgjatjen e orarit të punës. Andaj, punonjësit iu janë drejtuar Entit kantonal të arbitrimit.

Ekonomia kryesore e ndërtimtarisë

Kështu arnojnë shefat sindikatën e tyre

Përmes pseudo-sindikatën shefat e ndërtimtarie duan ta qesin jahte Kontratës Kombëtare të Punës sindikatën Unia dhe kështu të përkeqësojnë në mënyrë drastike kushtet e punës për punëtorët e ndërtimtarisë.

Shumë njerëz në ndërtimtarie nuk duket të kenë dëgjuar për Novatrava. Zyrtarisht kjo është themeluar nga «Kuatrot e ndërtimtarisë së Zvicrës» (Shoqata e drejtorëve të ndërtimit) dhe do të duhej të ishte organizata e parë e punëmarrësve «vetëm për ndërtimtarie». Një shoqatë «pa ngarkesa ideologjike». Një forcë lëvizëse prapa këtij projekti është drejtoresha menaxhere e kuadrit të ndërtimtarisë Barbara Schiesser.

Ky «çakëll ideologjik» është një goditje e qartë kundër Unia-s. Edhe pse para mediave Schiesser deklaroi se Novatrava nuk domethënë shpallje lufte sindikatës. Qëllimi gjoja është tu drejtohet njerëzve të paorganizuar. Kjo është thjeshtë hedhje hi syve, nëse jo gënjeshtër dhe mashtrim. Më vonë, pas një kohe të shkurtër Schiesser në gazetën e shefave të ndërtimtarisë «Industria e ndërtimit» vlerësoi Novatrava-n shprehimisht si «alternativë për sindikatën ekzistuese».

Bandë e ngushtë

Ka një kohë të gjatë që shoqata zvicerane e ndërmarrësve të ndërtimtarisë (SBV) dhe Kuadrot zvicerane të ndërtimtarisë janë të lidhura ngushtë dhe kultivojnë marrëdhënie të ngushta – në dëm të punëmarrësve në ndërtimtarie. Funkionarët e SBV-së janë mysafirë të rregullt në manifestimet e brendshme të kuadrove zvicerane të ndërtimit dhe atje në mënyrë sistematike krijojnë një atmosferë armiqësore kundër Unia-s. Edhe nëpër Panaire Kuadrot zvicerane të



Punëtorët e ndërtimtarisë janë vigjilentë dhe nuk mund ti mashtrorë askush

ndërtimit organizon tavolina të përbashkëta dhe prezantohen bashkë me Shoqata e drejtorëve ndërtimtar. Nuk është për tu çuditur, pasi firmat e ndërtimtarisë janë pjesë e «anëtarësisë pasive» të Shoqatës së kuadrove të ndërtimit.

Bosët e ndërtimit propagandojnë për Novatrava në mënyrë ofensive. Në gazetën e tyre ky projekt është prezantuar shumë herë. Mes SBV-së dhe Shoqatës së kuadrove të ndërtimit ekzistojnë edhe lidhje të ngushta personeli. Në Zvicrën perëndimore selia e SBV-së është njëherazi edhe sekretariati i Shoqatës së kuadrove të ndërtimit!

Përkeqësim i KKP-së

Kryetari i kuadrove të ndërtimit, Adrian Hässig, i cili vet është ndërmarrës dhe udhëheqës ndërtimi, e pranon edhe vet se i zgjat dorën – si tha ai para mediave – fleksibilitetit. Konkretisht kjo domethënë shkurtime pagash dhe paga më të ulëta fillestare për punëmarrës me arsimim të kufizuar.

Një Kontratë kundër punëtorëve – në frymën e shefave

Qëllimi i deklaruar i iniciuesve të Novatrava-s është pjesëmarrja në bisedimet për Kontratën Kombëtare të Punës. Së fundit u përpjekën bashkë me shefat që të përjashtojnë Unian. Me një pseudo-sindikatë të afërt me punëdhënësit duhet që Unia e pakëndshme të njolloset dhe përmes manovrimeve të përjashtohet. Ashtu që një KKP e re të mund të negociohet vetëm me Novatrava-n.

Lojë mendimesh

Përkundët krejt kësaj deri më tani ka munguar suksesi. Barbara Schiesser përgjigjet në pyetjen e shtruar sa anëtarë ka Novatrava: «Ndërtimit të një grupi të ri profesional i nevojitet kohë». Për gazetën «Sonntags Zeitung» kryetari kryesor Hässig dhjetorin e kaluar pat deklaruar për numrin 100 të anëtarëve. Nico Lutz, përgjegjësi për ndërtimtarie në Unia, tregohet i rehatshëm: «Nuk do të ketë asgjë nga kjo. Punëtorët e

ndërtimtarisë nuk mund ti bëjë buallan askush.» Mbi gjyma e gjithë punëtorëve të ndërtimtarisë të Zvicrës janë anëtarë të Unia-s. Më tej Lutz sh-ton: «Një pseudo-sindikatë, e cila ndihmon shefat e ndërtimit, nuk ia kanë nevojën punëtorët e ndërtimtarisë».

© Ralph Hug përshtatur, work, 23.1.2015

Bashkërisht me Shoqatën e udhëheqësve të ndërtimit «Baukader Schweiz» SBV-ja kah mesi i vitit 2014 ka bërë publike pseudo-sindikatën «Novatrava». Qëllimi është përçarja e punëtorëve të ndërtimtarisë dhe duke anashkaluar Unia-n të përkeqësohen kushtet e punës. Tani përipiqen tu mbushin mendjen që të anëtarësojnë sa më shumë punëtorëve ndërtimtarie. Andaj: **Kujdes dhe duart larg nga mashtrimi i «Novtrava»-s!** Dhe nëse diçka dëgjon lajmëro gjithsesi Unia-n në **bau@unia.ch**.

Politika e migracionit: Kongresi i parë i migrantëve e migrantëve dhe njerëzve me sfond migracioni

Jo dëbimittë bashkëqytetarëve

Një delegacion e pjesëmarrësve të Kongresit të parë të migrantëve/eve dhe njerëzve me sfond migracioni, ndër të cilët shumë përfaqësues të Unia-s i kanë dorëzuar më 10 mars një rezolutë kryetarit të Parlamentit të Zvicrës, Stéphane Rossini. Përmes kësaj rezolute ata kërkojnë ndalimin e dëbimeve të njerëzve, të cilët janë rritur në Zvicër, apo të cilët këtu kanë qendrën e tyre të jetesës.

Me rastin e debatit të datës 11 mars mbi zbatimin e iniciativës dëbuese në Parlamentin e Zvicrës (shih njoftimin në kornizë), një numër i madh i organizatave të migrantëve i kanë dorëzuar kryetarit të parlamentit Stéphane Rossini një rezolutë kundër dëbimit të njerëzve që janë rritur në Zvicër. Kjo rezolutë është aprovuar nga Kongresi i parë i migrantëve e migrantëve dhe

njerëzve me sfond migracioni, të mbajtur më 7 shkurt 2015 në Bernë. Rreth 250 pjesëmarrës dhe mbi 50 organizata u deklaruan për një politikë solidarizuese migracioni.

Të merret në konsideratë përqendrimi jetësor

«Atdheu është aty, ku është rritur njeriu», thuhet në rezolutë. Për këtë arsye, njerëzit që fokus të tyre jetësor e kanë Zvicrën, nuk guxojnë të dëbohen, kërkojnë organizatat pjesëmarrëse, në Kongres e parë të migrantëve. Nuk është në përputhje me të drejtat themelore të njeriut dëbimi i dikujt në një vend, përderisa ata kanë familjet e tyre dhe kontaktet sociale në Zvicër.

Lëvizje e gjerë e migrantëve

Sot aktivistët, krahas rezolutës, kryetarit të parlamentit si dhe parlamentarëve dhe bashkëpunëtorës personale të kryetares së Qeverisë Federale Simoneta Samaruga i dorë-



Aksioni i 10 marsit 2015 kur u dorëzua edhe rezoluta

zuan edhe kërkesat tjera të Kongresit të migrantëve si dhe manifestin e Lëvizjes. Në manifest, ata Zvicrën e konsiderojnë «vend të formësuar nga migracioni» dhe kërkojnë të drejta të njëjta për migrantet/ët. Ky aksion u mbështet nga shumë parlamentarë zviceranë, të cilët shoqëruan dorëzimin e dokumentacionit.

Në ke këtë seancë parlamentare është shqyrtuar iniciativa dëbuese. Parlamenti ka aprovuar tekstin, i cili parasheh që njerëzit pa pasaportë zvicerane, të cilët kryejnë ndonjë krim mund të dëbohen automatikisht. Megjithatë teksti i ligjit parasheh edhe përjashtime: Me rastin e rasteve personale të vështira duhet heqë dorë nga dëbimi.

© Aurora García

Arka e pensionit

Dëftesa e arkës së pensionit: Kështu mund ta lexoni

Personaldaten / Données personnelles				
Name und Vorname	Muster Felix	Eintritt	01.01.2013	
AHV-Nummer	756.2548.2546.21	Rücktrittsalter	65	
Geburtsdatum	01.01.1970	Beschäftigungsgrad	100% 1	
Verheiratet	ja	Heiratsdatum	11.11.2011	
Lohndaten / Données				
1 Brutto-Jahreslohn / Salaire annuel brut	CHF 78'000.00			
2 Versicherter Jahreslohn / Salaire annuel assuré	CHF 53'325.00			
Versicherte Leistungen / Prestations assurées				
A Altersleistungen im ordentlichen Rücktrittsalter am 01.02.2035 / Prestations de vieillesse à l'âge ordinaire de retraite, le 01.02.2035				
3 Budgetiertes Altersguthaben / Avoir de vieillesse prévisionnel	projiziert mit 1,75% Zins	CHF 301'677.00		
Projiziertes Altersguthaben ohne Zins		CHF 242'946.00		
4 Budgetierte jährliche Altersrente / Rente de vieillesse annuelle prévisionnelle	Umwandlungssatz 6,8%	CHF 20'514.05		
5 Budgetierte jährl. Pensionierten-Kinderrente je Kind / Rente annuelle prévisionnelle d'enfant de retraité-e	20% der Altersrente	CHF 3'861.45		
Hinterlassenenleistungen / Prestations de survivants				
6 Jährliche PartnerInnenrente / Rente annuelle de partenaire	3,84% des projizierten Altersguthabens	CHF 9'329.15		
Jährliche Waisenrente je Kind / Rente annuelle d'orphelin-e	28% des projizierten Altersguthabens	CHF 3'109.70		
7 Invalidentleistungen / Prestations d'invalidité				
Jährliche Invalidenrente	40% des Brutto-Jahreslohns	CHF 31'200.00		
Jährliche Invaliden-Kinderrente je Kind	1,28% des projizierten Altersguthabens	CHF 3'109.70		
8 Finanzierung / Financement				
	mtl. Sparbeitrag	mtl. Risikobeitrag	mtl. Verwaltungskosten	Total
Arbeitnehmende	CHF 222.65	CHF 49.45	CHF 13.65	CHF 285.75
Arbeitgebende	CHF 222.65	CHF 49.45	CHF 13.65	CHF 285.75
Sparbeitrag laufendes Jahr 2015	10% des versicherten Jahreslohns		CHF 5'343.60	
Risikobeitrag laufendes Jahr 2015	CHF 1'186.80			
Verwaltungskostenbeitrag laufendes Jahr 2015	CHF 327.60			
Gesamtbeitrag laufendes Jahr 2015	CHF 6'858.00			
9 Total Altersguthaben am 01.01.2015 / Total avoir de vieillesse au 01.01.2015	CHF 50'941.55			
davon Altersguthaben gemäss BVG	CHF 40'866.55			
10 Maximale Einkaufssumme / Somme maximale de rachat	CHF 42'600.00			
Stand Sparkonto per 31.12.2015	CHF 65'824.35			
Eingebrachte Freizügigkeitsleistung laufendes Jahr - Total	CHF 8'500.00			
Eingebrachte Freizügigkeitsleistung laufendes Jahr - Anteil BVG	CHF 4'000.00			

Sa keni kursyer deri tani, sa e lartë do te jetë pensioni juaj dhe sa janë përfitimet në rast invaliditeti: Këto dhe shumë të tjera qëndrojnë të shënuara në dëftesën e arkës suaj të pensionit.

- 1 Paga bruto**
Kontrollojeni, nëse paga juaj bruto është e njëjtë me dëftesën e rrogës suaj (për deklarim të tatimit): Nëse në vitin e fundit keni pasur një rritje rroge, duhet të shihni më me kujdes. Pos kësaj: A qëndron edhe shkalla e saktë e përqindjes së punësimit krahas pagës?
- 2 Paga e siguruar**
Paga e siguruar është paga juaj bruto pasi të jetë hequr e ashtuquajtura zbritje koordinuese prej 24 675 frangave. Kjo është ajo pjesë e pagës, e cila është e siguruar tek shtylla e parë e sigurimeve shoqërore (AHV/AVS). Në mënyrë të detyrueshme janë të siguruara të gjitha pagat mes 21 150 frangave dhe 84 600 frangave. Ka edhe arka të pensionit, të cilat vullnetarisht sigurojnë edhe atëherë kur fitoni më pak se 21 150 franga apo edhe më shumë se sa 84 600 franga në vit. Në të dy rastet fjala është për të ashtuquajturën pjesë jo-obliguese. Shihni rregulloren e arkës suaj të pensionit, se si e trajton ajo këtë çështje.
- 3 Kredia (kursimi) buxhetore**
Këto janë paratë, të cilat pritet ti keni kursyer deri në pensionimin tuaj. Megjithatë, kjo është vetëm një llogaritje e përafërt. Kjo parallogaritje supozon se ju do të vazhdoni të fitoni të njëjtën sasi si më parë. Dhe se norma minimale e interesit mbetet e njëjtë.

- 4 Pensioni vjetor i pleqërisë**
Edhe kjo shifër është një prognozë. Ajo tregon pensionin e parashikuar që ju do të merrni në vit pas daljes në pension. Arkat llogaritin shumën duke përdorur normat fikse të konvertimit në kursimet e pensionit. Aktualisht këto janë 6,8 për qind. Kjo do të thotë se pensioni juaj vjetor d të jetë 6.8 për qind e kapitalit të akumuluar nga ju deri atëherë.
- 5 Pensioni i fëmijëve**
Nëse fëmijët tuaj me rastin e pensionimit tuaj janë ende në moshë minor, apo edhe më tej në shkollim, arka e pensionit ju paguan juve edhe një pension për fëmijët. Këtu mund të shihni shumën të cilën marrin fëmijët tuaj në rast të tillë.
- 6 Përfitimet në rast vdekjeje**
Nëse vdisni para pensionimit të rregullt, trashëgimtarët tuaj si bashkëshorti/ja apo partneri/ja juaj si dhe fëmijët tuaj kanë të drejtë për pension nga arka e pensionit. Është mirë të dini: Shumë arka të pensionit paguajnë një pension të tillë edhe për partnerin/ën tuaj edhe nëse nuk jeni të martuar zyrtarisht. Shihni rregulloren e arkës suaj të pensionit. Nëse dëshironi që partneri/ja juaj të përfitoj nga arka e pensionit, atëherë për këtë duhet të lajmëroni vet ju arkën tuaj të pensionit.
- 7 Përfitimet në rast invaliditeti**
Sikur shtylla e parë ashtu edhe ajo e dyta paguajnë pensione invaliditeti: Dhe atë sikur për juve ashtu edhe për fëmijët tuaj, nëse këta janë ende të moshës jomadhore apo duke vijuar shkollimin. Në rregulloren arkës suaj të pensionit qëndron se si llogariten këto pensione.

- 8 Financimi**
Kontributet për arkën tuaj të pensioneve zbriten nga pagat tuaja. Të paktën të njëjtën kontribut paguan edhe punëdhënësi juaj. Për llogaritetni edhe ju për të parë nëse ata pajtohen me të dhënat në deklaratën tuaj të pagave. Nëse ju gjatë vitit keni ndërruar vendin tuaj të punës, me këtë rast ndryshon edhe arka juaj e pensionit, atëherë kursimet tuaja përfituese transferohen në arkën e re dhe kjo shumë e të hollave të transferuara duhet të jenë të evidentuar këtu. Kontrolloni mirë: domethënë brenda 30 ditë pas ditës së fundit të punës, paratë duhet të jenë transferuar në konton e re. Për këtë qëllim, arka e pensionit ka nevojë por të gjitha informacionet e nevojshme dhe këto duhet ti ofroni vet ju.
- 9 Kursimet e pensionit**
Qaq para keni kursyer deri më 1 janar 2015. Në pjesën e detyrueshme ky kapitali i kursyer duhet të përmban normën e caktuar minimale të interesit që përcaktohet nga qeveria federale. Aktualisht kjo normë është rreth 1,75 për qind. Megjithatë, arkat e pensionit mund të jetë bujare, në qoftë se ato duan.
- 10 Bjerja**
Nëse juve u mungojnë vitet e kontributeve, apo nëse doni të siguroheni për pension të mëhershëm, keni mundësi shtesë të blerje në shtyllën e dytë. Këtu është e shënuar sa keni paguar. Apo: sa është dashur të paguani, për të marrë përfitimet e plota.

Sina Bühler
pëstatur nga work Nr. 3, 20. Februar 2015

Intervistë



Beat Baumann

Intervista frangu i fuqishëm

Jo në kurriz të punëmarrësve!

Më 15 janar 2015 Banka Kombëtare e Zvicrës (BKZ) ka hequr pengesën e kursit minimal të Euros prej 1.20 frangave. Frangu u shtrenjtua bashkë me të mirat që i eksportojnë Zvicra. Për pasojat e këtij vendimi biseduam me Beat Baumann, ekonomistin përgjegjës në Unia.

Cilat janë pasojat e këtij vendimipër vendet e punës, pagat dhe ekonominë?

Kush ke ndërmend që të bëjë pushime apo të vizitohet familjarët në hapësirën e BE-së, tani paguan më lirë. Edhe paga apo pensioni i pleqërisë i Zvicrës në hapësirën e BE-së tani kanë më shumë vlerë. Mirëpo le anash këto, pasojat janë negative. Ndërmarrjet janë duke i humbur mandatet apo ti ulin çmimet, pasi konkurrentët nga BE-ja janë më të lirë. Si pasojë e kësaj ato duan ti ulin harxhimet.

A nuk është e kuptueshme që ata tani duan ti ulin çmimet?

Jo, pasi përmes uljes së pagave, ato dëshirojnë ti sigurojnë fitimet e tyre në kurriz të punëtorëve. Kjo është jo korrekte, pasi të punësuarit nuk duhet të gjobiten për mbivlerësimin e frangut? Nëse ndodhë ulja sistematike e pagës duke e ndërlidhur këtë me kursin e këmbimit, kjo paraqet zhvendosje të rrezikut prej ndërmarrjeve tek punëmarrësit. Këtë e ndalon edhe ligji i punës.

Mirëpo ka edhe ndërmarrje, të cilat vërtetë përballen me vështirësi?

Po, më të prekura janë ndërmarrjet e industrisë eksportuese, p.sh. ato që merren me pajisjen e industrisë së automobilave dhe ato hoteliere. Nëse firma mund të dokumenton vështirësitë ekonomike, Unia është e gatshme në bashkëbisedim të kërkojë zgjidhjen më të mirë. Mirëpo, edhe në këtë rast duhet të garantohet mbrojtja e largimit nga puna të punëtorëve. Punëtorët e prekur duhet të drejtohen tek Unia. Bashkërisht mbrohemi nga përkeqësimi i kushteve të punës, po e deshi puna edhe përmes grevës.

Nëse një ndërmarrje humbë mandatet, atëherë nuk ndihmojnë as rritjet e orarit të punës.

Në raste të tilla ndërmarrja mund të aplikon tek sigurimi i papunësisë për kompensim shkaku i orarit të shkurtuar të punës. Për një pjesë të punësuarve mund të reduktohet orari i punës dhe sigurimi në fjalë paguan 80% të pagës se prekur. Një instrument i mirë ky që ndërmarrjet të mos largojnë punëtorët nga puna.

Si janë parashikimet ekonomike, a do të ketë recesion dhe çka domethënë kjo për të punësuarit?

Kjo varet nga dy gjëra. E para: Gjendja ekonomik në Evropë duhet të merr rrugë të mbarë. Andaj nevojiten investime gjithandej, jo vetëm në Evropën jugore, edhe në Gjermani; E dyta: Zvicra ka nevojë të përmblyllë mirë pagat, pasi ato mbështesin kërkesat në vend, e të cilat mbështesin koniunkturën në Zvicër. Andaj, ulja e pagave dëmton shumë Zvicrën.

Çka nevojitet që Zvicra të tejkaloi pa pasojat këto kohëra të vështira?

BKZ duhet të siguroi përsëri kursin minimal, ndoshta tek pragu 1.15 franga. Kjo është kërkesa kryesore e sindikatave. Frikës së madhe për humbjen e vendeve të punës i duhet garantimi i arsimimi dhe trajnimit i mëtejshëm të punëtorëve. Kjo është shumë e rëndësishme.

Aurora Garcia



Aksioni kundër zhvendosjes së pasojave tek punonjësit

Protestat e punëtorëve vijnë duke u shtuar e shpeshtuar nga dita në ditë

Bota e punës në Kosovë

4 Mars 2015

Punëtorët e «Llamkosit» u kthehen protestave

Njëra hyrje e Qeverisë së Kosovës është bllokuar sërish nga punëtorët e fabrikës për punimin e llamarinës «Llamkos». Ata duan pagat dhe mosfalimentimin e fabrikës. Ata po vazhdojnë t'i kërkojnë pagat e tyre, të cilat kompania blerëse «Core Group» nuk ua ka dhënë disa muaj, raporton KTV.



Pamje nga protestat e punëtorëve të Llamkosit

Përpos kërkesave për gjetjen e një zgjidhjeje për dhënien e pagave të tyre, protestuesit kanë kërkuar edhe moslejimin e falimentimit të fabrikës që dikur nga AKM-ja ishte konsideruar.

Pos mosdhënies së pagave, kompania blerëse ka mashtruar edhe AKP-në. Ky institucion nuk është njoftuar fare se blerësi e ka futur «Llamkosin» në hipotekë në «Standard Bank» në Britani, pavarësisht se në kontratë nuk i është ndaluar ta bëjë një gjë të tillë.

Prandaj AKP-ja nuk pritët të ndërmarrë asnjë veprim për ruajtjen e kësaj ndërmarrjeje nga likuidimi, pos që do të kërkojë nga gjykata që të jetë e përfaqësuar në bordin e kreditorëve, përcjell koha.net. AKP-ja ka thënë të mos ketë asnjë mundësi që të parandalojë shitjen e «Llamkosit».

Marrë nga e përditshmja KOHA.net

5 Mars 2015

BSPK e hedh në gjyq Aeroportin

37-ish punëtorë të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës «Adem Jashari» do të paraqiten në Gjykatën Themelore të Lipjanit për të dëshmuar kundërshtimin e tyre për largim nga puna, raporton KTV.



Nga konferenca për media e BSPK-së

Pavarësisht këtij procesi, menaxhmenti i këtij aeroporti këtyre ditëve ka larguar edhe 17 punëtorë të tjerë.

Ky veprim nuk i ka pëlqyer BSPK-së, e cila e ka hedhur në gjyq Aeroportin, pasi vlerësojnë se menaxhmenti aktual po merr veprime në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Sipas tyre menaxhmenti i aeroportit duhet të konsultohet me sindikatën para se të marrë vendim për t'i larguar punëtorët nga puna.

Madje sindikalistët kanë thënë se largimi punëtorëve është fshehur nga menaxhmenti. Mirëpo me këto deklaratat i ka kundërshtuar menaxhmenti i ANP-së.

Ata kanë thënë se të gjitha informacionet u janë dhënë sindikalistëve në takimin që këta të fundit kanë kërkuar ta mbajnë të mrekurën. Menaxhmenti i Aeroportit ka bërë të ditur se nuk kanë në plan të bëjë largime të tjera.

Marrë nga e përditshmja KOHA.net

20 Shkurt 2015

Punëtorë të ndërmarrjeve në Kaçanik protestojnë për aksione

Punëtorë të ndërmarrjeve Sharr Salloniti, Lepenci dhe të Çimentores kanë protestuar në Kaçanik, duke kërkuar nga institucionet e larta të shtetit të ndërmarrin masa të shpejta për t'u dalë në ndihmë, raporton KTV.



Pamje nga protesta e punëtorëve të aeroportit

Të irrituar me situatën e vështirë ekonomike në të cilën gjenden, ata kanë akuzuar blerësit e ndërmarrjeve, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Qeverinë e Kosovës që të njohin të drejtën e tyre të aksioneve nëpër këto ndërmarrje. Një kërkesë të tillë ata e kanë bazuar në vendimin e nxjerrë nga ish-Gjykata Ekonomike më 1991 dhe e pranuar nga administrata e UNMIK-ut, me të cilën punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve u njohet e drejta e aksionarëve të këto ndërmarrje.

Para Komunës së Kaçanikut, protestuesit kanë kërkuar ndihmë edhe nga kryetari Besim Ilazi.

Ky i fundit ka thënë se u jep përkrahje në kërkesat e tyre, por se fuqia e tij para kërkesave të tyre është e vogël me ligj, andaj ka kërkuar nga ta që të drejtohen tek institucionet e tjera, përcjell koha.net. Protestuesit kanë paralajmëruar protesta të tjera, për të cilat nuk kanë përjashtuar mundësinë që t'i mbajnë në Prishtinë.

Marrë nga e përditshmja KOHA.net

Mars 2015

Punëtorët e Hotel Grand-it dorëzojnë peticionin

92 punëtorë të «Hotel Grand» kanë nënshkruar një peticion, përmes të cilit kërkojnë të drejtat e tyre. Peticioni ka katër kërkesa kryesore, të cilat, nënshkruarit e tij ia kanë paraqitur Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi gjinore, Persona të pagjetur dhe Peticione.



Hotel Grand-i i degraduar i Prishtinës

Punëtorët kanë kërkuar që të lidhen kontrata për shërbimet për të gjithë punëtorët e «Grand Hotel» dhe të zhblokohet situata e krijuar nga AKP-ja si dhe kanë kërkuar të mbeten në punë të gjithë punëtorët e «Gand Hotel»-it me vetëfinancim deri në shtije e tij.

Mustafë Ahmeti – kryetar i sindikatës së «Grand Hotel» tha se të drejtat e punëtorëve janë shkelur në mënyrë barbare nga AKP-ja. «Zyrtarët e departamentit të likuidimit të AKP-së të cilët janë të organizuar mirë me paramendim që të shkatërrojnë ndërmarrjen «Grand Hotel» tani kanë vënë barriera të projektuara», tha ai. «Kërkojmë që pagat të jenë të plota si deri më tani, të merren masa për zhblokimin e financave lidhur me pagat e punëtorëve, të mos pengohet aktiviteti sindikal në «Grand Hotel», shtoi kreu i sindikatës, Mustafë Ahmeti.

Ndërkaq, Avni Jashari, ushtrues detyre i drejtorit menaxhues për likuidim në AKP, tha se Kuvendi ende nuk e ka emëruar Bordin e Drejtorëve, dhe për këtë arsye ai tha se është shtyrë procesi i likuidimit të «Hotel Grand»-it.

«Duke parë situatën në fjalë, në raportet financiare të cilat i ka përgatitur Autoriteti i Likuidimit dhe sipas ligjit të Agjencisë, janë përgatitur analizat financiare të kësaj ndërmarrjeje dhe është ardhë në përfundim se nëse mbahet niveli i pagave aktuale, atëherë në përditshëm 1 vjeçare, «Grand Hotel» do të ishte në minus 144 mijë euro», tha ai. Në fund të prillit, sipas tij, do të shihet situata financiare e «Grand-it» dhe do të vendoset nëse këta punëtorë të cilët nuk konsiderohen të punësuar prej datës 2 shkurt, do të mbahen edhe më tej apo do të rritet niveli i pagave të tyre. Kurse Teuta Haxhiu, anëtare e komisionit ka pasur disa kritika për AKP-në. «Politika është edhe në institucionin tuaj. Ju nuk jeni kompetent me marrë vendime përderisa nuk keni bordin e kompletuar. Të gjitha vendimet e juaja janë të kundërligjshme», ka thënë ajo.

Marrë nga e përditshmja Kosova Sot

Osman Osmani



Paratë e arkës se pensionit: A mund të blejmë me to një banesë?

Gruaja ime dhe unë jemi rreth të katërdhjetave dhe që të dy të punësuar: Ne jemi duke menduar me partë e arkës së pensionit të gruas sime ti përdorim për të blerë një banesë apo një pushimore për veti. Në cilat kushte është e mundur kjo?

Një nga kushtet e rëndësishme për tërheqjen e hershme të përfitimeve vetjake, pra tërheqjen e parave të pensionit është pronësia personale ose e përbashkët e një prone. Shtëpia apo banesa në pronësi duhet i shërbejë si vendbanim vet personit apo familjes së tij. Banesa e dytë dhe pushimorja nuk mund ti financoni nga partë e arkës së pensioni. Edhe blerja e një objekti, te cilin doni ta jepni me qira, nuk është i mundur. Tërheqjen keni mundësi ta bëni çdo 5 vite. Shuma minimale e tërheqjes duhet të jetë më së paku 20000 franga. Pos kësaj ka kufizime për ata që janë mbi 50 vjeç: Të siguruarit që kanë kaluar moshën 50 vjeç, kanë të drejtë të tërheqin shumën, të cilën e kanë pasur si kapital te kursyer vetjak deri në moshën 50 vjeç. Apo gjysmën e përfitimeve poseduese në kohën që vendos ti tërheqë.

Meqë ra fjala: Përveç se për përdorim banimi personal, ju parat nga arka e pensionit mund të investoni në pronën ekzistuese rezidenciale, për shembull për një izolim fasade ose renovim tjetër. Përfitimet vetjake nga arka e pensionit, ju gjithashtu mund të përdorni për reduktimin e hipotekës (por jo për pagesën e interesit peng). Ose ju ato mund ti përdorni edhe si certifikatë aksionesh për bashkëpronësi në kooperativat banesore.

Phillip Thomas, work, 19.2.2015

Dora e thyer: Kush paguan kostot e aksidentit?

Unë punoj qe gjysmë viti si luleshitëse në një shitore të vogël lulesh. Para nja tri javësh kam rrëshqitur në akull dhe kam thyer dorën e majtë. Pasi që si punëmarrëse jam detyrimisht edhe e siguruar në raste aksidenti, tek arka ime shëndetësore nuk jam siguruar kundër aksidenteve. Tani doja ta dija nga shefi im se tek cili sigurim aksidental jam e siguruar. Pas një zvarritje ai për shkaqe kostoje nuk ka përmbyllur fare sigurim aksidental për të tre të punësuarit e tij. Unë tani jam e shqetësuar. A duhet unë vet tani ti paguaj llogaritë e mjekut dhe ato të spitalit?

Jo. Si punëmarrëse sipas ligjit jeni e siguruar edhe kundër aksidenteve. Ndoshtë shpesh që shefat sipas rregullave nuk i sigurojnë të punësuarit e vet. Andaj ligjdhënësi k obliguar shoqëritë e sigurimeve, të krijojnë një të ashtuquajtur arkë zëvendësuese. Kjo vjen në shprehje në rast të mosekzistimit të sigurimit dhe nëse ligjërisht nuk është përgjegjës (SUVA) Enti Zvicëran i Sigurimit Aksidental (kjo vlen për shembull për sektorin e ndërtimtarisë dhe industrisë). Arka zëvendësuese vjen në shprehje kur sigurimi aksidental për shkak të paaftësisë të pagesës nuk është në gjendje të sigurojë shërbimet e kërkuara.

Tek arka zëvendësuese fjala është për një Fondacion, këshilli i së cilit përbëhet nga përfaqësues të Shoqërive të sigurimit dhe përfaqësuesve të Organizatave punëdhënësve si dhe ato të punëmarrësve. Adresa ku ju duhet të lajmëroheni, është: Ersatzkasse UVG, Postfach, 8010 Zürich. Telefon 058 358 05 70, www.ersatzkasse.ch. Me që ra fjala: Për shefin tuaj e tërë kjo çështje ka një dëmtim. Pasi ai padrejtësisht nuk ka lidhur një sigurim aksidental, atij më vonë i duhet të kompensojë premitë zëvendësuese.

Peter Schmid, work, 20.3.2015

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, D. Filipovic, E. Sariastan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck NZZ Print, Zürcherstrasse 39, 8952 Schlieren | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch